

VENDIM
Nr.543, datë 12.8.2004

PËR RRITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKUT NË REZERVË (LIRIM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18 e 21 të ligji nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen në masën 8 për qind të pagesës kalimtare të ushtarakut në rezervë (lirim), të caktuar deri më datë 1.7.2004, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Këtë rritje e përfiton ushtaraku i nxjerrë në rezervë (lirim) nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ të Shtetit.

2. Efektet financiare të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2004, miratuar, përkatësisht, për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe Shërbimin Informativ të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano